



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:026414

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05589083

**P.nr.61/2024**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani Rahimi, në çështjen penale ndaj të pandehurit L... L... nga Gjilani të cilin me autorizim e përfaqëson av. Elvira Haziri nga Gjilani, për shkak të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilani, PP.II.nr.178 /2024 të datës 31.01.2014, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 27.03.2024, shpalli dënimin, kurse me datë 18.04.2024 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

I pandehuri **L...L...**, nga babai A..., nëna I..., e gjinisë B., i lindur më .... në Gjilani me vendbanim në rrugën "M.... I..." nr.... në Gjilani, i pa martuar, i pa punë, me gjendje së mesme ekonomike, me nr. Personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR SEPSE

Me datë 22. Janar 2024, rreth orës 20:20 min, tek fusha e sportit në rrugën "...", në Gjilani pas një kontrolli nga ana e zyrtarëve policorë i pandehuri . ka sulmuar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare edhe atë zyrtarin policor ., ashtu që në momentin kur i dëmtuari kërkon që nga i pandehuri që ta kontrollojë, i pandehuri fillimisht e fyen me fjalë të rënda ofenduese dhe kanosëse "kush jeni ju me më kontrollu mu...unë kam me ju deshe prej uniformes....ju jeni kriminelë polic, jav q... nanen krejt policëve, ...s'kam me ju lan vend kerkun juve... s'kam me ju lan gjallë...."e më pas ia shtyen duart e me pas e sulmon duke e kapur për fyti dhe duke ia shkyer bluzën, kështu që i pandehuri me veprimet e tij i ka drejtuar kundër të mirës juridike që konsiston në rrezikimin e integritetit turpor dhe autoritetin e zyrtarit në kryerjen e detyrave zyrtare, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit, i cili për shkak të

natyrës së lëndimeve detyrohet që të kërkoj trajtim mjekësor në Emergjencën e Spitalit Regional në Gjilan.

-me çka ka kryer veprën penale , **Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes se detyrës zyrtare nga neni 402 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK**

Prandaj gjykata duke iu referuar marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë në mes të Liburn Limoni dhe Prokurorisë Themelore-Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan dhe në bazë të dispozitës ligjore dhe neneve 4, 38, 42, 44, 69, 70, 71, dhe 72 si dhe nenit 230 dhe 364 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurin **Liburn Limoni** :

## **E GJYKON**

**I.Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk**,do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale.

**II.**Konform nenit 87 të KPRK, i propozojmë Gjykatës që ndaj të pandehurit të shqiptojë masën e trajtimit me anë të rehabilitimit të detyrueshëm në institucionin e kujdesit shëndetësor për personat e varur nga droga ose alkooli.

**III.** Konform nenit 56 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të KPRK-ës gjykata të urdhërojë të pandehurin që ta përbush detyrimin e tij për nënshtrimin në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit në qendrën e shëndetit mendor në Gjilan.

**IV.Të URDHËROHET Shërbimi Sprovues i Kosovës - Zyra Rajonale në Gjilan** që të mbikëqyr dhe të ekzekutoj dënimin me kusht dhe njëkohësisht,

**OBLIGOHET i akuzuari .....**të mbaj kontakt të rregullt me Shërbimin Sprovues të Kosovës - Zyra Rajonale në Gjilan.

**V.** Komfor nenit 55 paragrafi 4 të KPRK-ës njoftohet i pandehuri që nëse nuk e mban kontaktin me shërbimin sprovues dhe nuk e përmbush detyrimin e paraparë në nenin 56 paragrafi 1, nën paragrafi 1.10 të KPRK-ës siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata do ta revokoj dënimin me kusht ashtu që i akuzuari do ta mbaj dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

**VI.**Në bazë të nenin 79 të KPRK-ës të akuzuarit të lartcekur koha e kaluar nën masën e paraburgimit, në rast të revokimit të dënimin të kushtëzuar do të llogaritet në dënimin me burgim.

**VII.Pala e dëmtuar ., për realizimin e kërkesës pasurore juridike bazë të nenit 462 paragrafi 2 të KPP-ës udhëzohet në kontest civilo juridik.**

**VIII.** Obligohet i pandehuri që të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 30 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

**IX.** Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### **1. Historiku i procedurës**

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, më datë 31.01.2024, ka ngritur aktakuzën e lartcekur, ndaj të akuzuarit nga Gjilani të cilin me autorizim e përfaqëson av. ., për shkak të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Me datën 27.03.2024, në këtë gjykatë është dorëzuar marrëveshja për pranimin e fajësisë lidhur në mes Prokurorisë Themelore në Gjilan/Departamenti i Përgjithshëm në njërën anë dhe në anën tjetër të pandehurit Liburn Limoni me mbrojtësen e tij av.. Sipas kësaj marrëveshje, kësaj Gjykate i është rekomanduar, që ndaj të akuzuarit , për shkak të veprës penale, të lartcekur ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë**

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datë 27.03.2024, gjykata pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit, ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij, se i pandehuri nuk ka qenë në as një mënyrë i detyruar apo i shtrënguar të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekziston as një nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP-së.

### **3. Gjendja faktike e vërtetuar**

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të këtyre veprave penale, ekziston fakti se i akuzuari ka kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **4. Elementet e veprës penale**

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve dhe të mbrojtësit lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin, për shkak të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtat është dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njëjti e ka pranuar edhe vet.

### **5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të pranohet rekomandimi i paraqitur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e

veprave penale. Me rastin e matjes së dënimit të akuzuarit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69,70,71, dhe 72 të KPRK-s, Kështu, si rrethanë lehtësuese është fakti se i akuzuari ka arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjilan / Departamenti i Përgjithshëm. Gjithashtu, si rrethana lehtësuese, gjykata ka marrë dhe faktin se i akuzuari ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit, se pranimin e fajësisë e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se i akuzuari ka shprehur keqardhje për kryerjen e këtyre veprave penale, se i njëjti më parë nuk ka kryer vepra penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i akuzuari me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese janë, përgjegjësia penale dhe rrezikshmëria shoqërore.

#### **6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.**

Gjykata, ka konstatuar se me denimin si në dispozitiv të aktgjykimit, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### **7.Vendimi për kërkesën pasurore juridike:**

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike bazë të nenit 462 paragrafi 2 të KPP-ës është udhëzuar në kontest civilo juridik.

#### **8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale**

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për të paguar, taksën për viktimat e krimit, shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.61/2024-Më 18.04.2024**

**Bashkëpunorë prof.**  
Vlora Selmani Rahimi

**Gjyqtar,**  
Veli Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE** : Ky aktgjykim është i formës së prerë, ditën e shpalljes së aktgjykimit në pajtim me nenin 230 të KPRK-së.me date **27.03.2024**.